

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.06.2020

NJOFTIM**Për mbledhjen Nr. 25, datë 24.06.2020, ora 13:00
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 24.06.2020, ora 13:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 25 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1- Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë MTC Energy sh.p.k., për transferimin e asetëve të saj nga "Raiffeisen Bank" sh.a, tek “Alpha Bank”

2- Mbi plotësimin e kushteve të vendimit të ERE-s nr. 43 datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të sekretariatit të komunitetit të energjisë, i ndryshuar”

3- Për shfuqizimin e pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 30.01.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Llëngë” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektirike nga Hec “Llënga 1” me fuqi 1730 kW, Hec “Llënga 2” me fuqi 300 kW dhe Hec “Llënga 3” me fuqi 1500 kW, me fuqi totale 3530 kW

4- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW

5- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e Hec Banja me kapacitet të instaluar 2 mW

6- Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore ndër vite dhe pagesën rregullatore për vitin 2019

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI